



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 20.03.2023

Nr: 29

Ora: 15:30

**VENDIM**

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 35, DATË 17.03.2023 TË DEPOZITUAR  
NGA PARTIA LËVIZJA PËR ZHVILLIM KOMBËTAR**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 20.03.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Elvis ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, përfaqësuar nga z. Fabian Topollari

**OBJEKT:** Korrigjim dhe kundërshtim i vendimit nr. 173, datë 14.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 10, dhe 17 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Data: 20.03.2023 Nr: 29  
Ora: 15:30



“Për pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 35 të partisë politike “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar””

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### **VËREN:**

Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar” ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 35 regj., datë 17.03.2023. Në mbledhjen e datës 20.03.2023, ora 15:30, pas relativitetit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 35 i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuar në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, dhe 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 35, datë 17.03.2023, të paraqitur nga Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 21.03.2023, ora 12:30.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

<b>Elvis ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>